



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Datë 28.07.2020

Për: Operatorin ekonomik “Erisoni Company” shpk
Adresa: Njesia Bashkiake nr. 7, Rruga Shefqet Musaraj, Pallati nr. 3, Kati I-re.

* * *

Procedura e prokurimit: “Procedurë e hapur”

Referenca e procedures: REF-59297-05-28-2020

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Blerje materiale për funksionimin e pajisjeve të zyrës të Bashkisë Tiranë”

Fondi limit: 12.499.990 (dymbëdhjetë milion e katërqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë) lekë pa tvsh.

Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin: Nga data e lidhjes së kontratës deri në 31.12.2020 sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor.

Publikime të mëparshme: Buletini i Njoftimeve Publike: Nr. 32 datë 01 Qershor 2020.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X

Njoftojmë se, ka qënë pjesëmarrës në procedurë ofertuesi ekonomik me vlerën përkatëse të ofruar si më poshtë:

1. Operatori ekonomik “Infosoft Office” shpk NUIS J62426002Q

Vlera e ofertës pa TVSH – 9.099.137 (nëntë milion e nëntëdhjetë e nëntë mijë e njëqind e tridhjetë e shtatë) lekë

Vlera e ofertës me TVSH - 10.918.964,4 (dhjetë milion e nëntëqind e tetëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e katër, presje katër) lekë

2. Operatori ekonomik “Interlogistic” shpk NUIS K21605003M

Vlera e ofertës pa TVSH – 10.100.100 (dhjetë milion e njëqind mijë e njëqind) lekë

Vlera e ofertës me TVSH – 12.120.120 (dymbëdhjetë milion e njëqind e njëzetë mijë e njëqind e njëzetë) lekë

3. Operatori ekonomik “IT Gjergji Kompjuter” shpk NUIS K81503063B

Vlera e ofertës pa TVSH – 10.691.711 (dhjetë milion e gjashtëqind e nëntëdhjetë e një mijë e shtatëqind e njëmbëdhjetë) lekë

Vlera e ofertës me TVSH – 12.830.053,2 (dymbëdhjetë milion e tetëqind e tridhjetë mijë e pesëdhjetë e tre, presje dy) lekë

4. Operatori ekonomik “Erisoni Company” shpk NUIS K92006501A

Vlera e ofertës pa TVSH – 7.807.600 (shtatë milion e tetëqind e shtatë mijë e gjashtëqind) lekë

Vlera e ofertës me TVSH - 9.369.120 (nëntë milion e treqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e

njëqind e njëzetë) lekë

5. Operatori ekonomik “Blueprint Technologies“ shpk

NUIS L82428011G

Vlera e ofertës – 0

Nuk ka dorëzuar ofertë ekonomike

6. Operatori ekonomik “Marketing & Distribution” shpk

NUIS J72124001N

Vlera e ofertës pa TVSH - 12.359.720 (dymbëdhjetë milion e treqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e njëzetë) lekë

Vlera e ofertës me TVSH – 14.831.664 (katërmëdhjetë milion e tetëqind e tridhjetë e një mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e katër) lekë

7. Operatori ekonomik “Adastra” shpk

NUIS L41826018M

Vlera e ofertës - 0

Nuk ka dorëzuar ofertë ekonomike

8. Operatori ekonomik “Adenis Kastrati” shpk

NUIS L51611004I

Vlera e ofertës pa TVSH - 8.888.890 (tetë milion e tetëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë) lekë

Vlera e ofertës me TVSH - 10.666.668 (dhjetë milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e tetë) lekë

Janë s’kualifikuar operatorët ekonomikë si më poshtë vijon:

- | | |
|--|------------------------|
| 1. Operatori ekonomik “Adastra” shpk | NUIS L41826018M |
| 2. Operatori ekonomik “Blueprint Technologies“ shpk | NUIS L82428011G |
| 3. Operatori ekonomik “Adenis Kastrati” shpk | NUIS L51611004I |

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

1. Operatori ekonomik “Adastra” shpk është s’kualifikuar për arsyet e mëposhtme:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjatë hapjes dhe shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur nga kjo shoqëri konstatoi se ajo nuk ka paraqitur në spe (sistemin elektronik) dokumentacionin ligjor, teknik dhe atë ekonomik c’ka e bën ofertën e tyre të pavlefshme.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”I ndryshuar **e shpall të pavlefshme këtë ofertë** pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit

2. Operatori ekonomik “Blueprint Technologies“ shpk është s’kualifikuar për arsyet e mëposhtme:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjatë hapjes dhe shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur nga kjo shoqëri konstatoi se ajo nuk ka paraqitur në spe (sistemin elektronik) dokumentacionin ligjor, teknik dhe atë ekonomik c’ka e bën ofertën e tyre të pavlefshme.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe

mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

3. Operatori ekonomik “Adenis Kastrati” shpk është s’kualifikuar për arsyet e mëposhtme:

1. AK ka kërkuar në piken 3 te kriterëve te veçanta të kualifikimit në rubrikën kapaciteti ekonomik dhe financiar si më poshtë vijon:

Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin, 2019 sipas Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” (i ndryshuar) dhe VKB Nr. 28, datë 24.03.2020 “Për krijimin e lehtësirave fiskale ndaj biznesit dhe shtyrjen e afateve të aplikimit për programet sociale të strehimit në kuadër të masave për parandalimin e përhapjes së infeksionit Covid-19”

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Komuna ose Bashkia në të cilën është regjistruar sipas QKR.

Në përmbushje të kriterit të kërkuar nga AK operatori ekonomik Adenis Kastrati sh.p.k ka paraqitur në sistemin elektronik vërtetim për shlyerjen e taksave vendore lëshuar nga Bashkia Kamëz.

Referuar ekstraktit historik të paraqitur në sistemin elektronik operatori ekonomik Adenis Kastrati rezulton se ushtron aktivitet në Durrës Fushë Krujë.

Nga verifikimi i dokumentacionit në sistemin elektronik të prokurimeve KVO konstaton se operatori ekonomik Adenis Kastrati sh.p.k nuk ka paraqitur vërtetimin e lëshuar nga Bashkia Fushë- Krujë për vitin 2019.

Përderisa rezulton që operatori ekonomik Adenis Kastrati sh.p.k vazhdon të ushtrojë aktivitet pranë Bashkisë Fushë-Krujë pra ka qënë i detyruar të paraqesë në sistemin e prokurimeve elektronike vërtetim për shlyerjen e taksave vendore për vitin 2019 ashtu siç është kërkuar në DT.

Sqarojmë se, kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

Neni 12 “Regjistrimi dhe Liçensimi” i Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar parashikon se: Taksapaguesit, subjekte të këtij ligji, regjistrohen, për qëllime fiskale, pranë Qendrës Kombëtare të regjistrimit, në përputhje me ligjin e posaçëm.

Ndryshimet në vendin e ushtrimit të veprimtarisë dhe të të dhënave të tjera tregtare kryhen sipas dispozitave të ligjit për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

2. AK ne kriteret per kualifikim konkretisht pika 2/3 a kerkuar si me poshte- Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

Dëshmi për furnizimet të ngjashme me objektin e prokurimit, me vlerë jo me te vogel se 40% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet, të realizuara gjatë tri viteve të fundit financiar nga data e zhvillimit te tenderit, ose 4.999.996 (katër milion e nëntëqind e

nëntëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e gjashtë).

Për të vërtetuar këtë Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- Kur furnizimi i ngjashëm është realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur Kontratën e nënshkruar me institucionin dhe vërtetimin e lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e plotë dhe të suksesshëm të kësaj kontrate, ku të jetë e përcaktuar dhe vlera e furnizimit të realizuar.

- Kur furnizimi i ngjashëm është realizuar me subjekte private, Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë furnizim duke paraqitur faturat tatimore përkatëse të shitjes të nënshkruara nga të dyja palët (ku të shprehen qarte datat, shumat dhe furnizimet e realizuara).

Nga shqyrtimi i bërë objekteve të ngjashme të realizuara nga ky operator ekonomik të paraqitura në sistemin elektronik dhe konkretisht ato të lidhura me institucione shtetërore sikundër është Bashkia Devoll, Reparti Ushtarak Nr 6640, Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura apo Bashkia Kukës etj rezulton që ky operator të ketë paraqitur vetëm faturën tatimore dhe vërtetimin e realizimit të këtyre kontratave por jo kontratën e lidhur me këto institucione ashtu sikundër është kërkuar dhe cilësuar në kriterin sa më sipër cituar duke mos përmbushur në tërësi kriterin e përcaktuar në pikën 2/3 rubrika Kapaciteti teknik

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreut VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar **e shpall të pavlefshme këtë ofertë** pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin ekonomik **"Erisoni Company"** shpk me adresë: Tiranë Njesia Bashkiake nr. 7, Rruga Shefqet Musaraj, Pallati nr. 3, Kati I-re se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 7.807.600 (shtatë milion e tetëqind e shtatë mijë e gjashtëqind) lekë pa tvsh dhe 9.369.120 (nëntë milion e treqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e njëqind e njëzetë) lekë me tvsh, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të veprohet sic parashikon Ligji nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë: 20.07.2020

Ankesa: Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në tender në mbështetje të Nenit 63 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë, **nuk është paraqitur asnjë ankesë.**